



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 36-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 23.04.2025.2025, në sallën numër 2, kati i 3-të, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Valon Pacolli, DEZH
2. Shkelzen Hajdini, DSHPS
3. Latif Ramadani, DBF
4. Rasim Hasani, DKA
5. Rexhep Rexhepi, DBPZHR

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë të cilin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 35-të e KPF-së.
2. Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2024.

3. Propozim Vendim mbi dhënjën e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2023 dhe 2024 në vitin 2025.
4. Informatë për punën e KKSB-së në Lipjan për vitin 2024.
5. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar – Mars 2025.
6. Propozim Vendim për miratimin e Planit të veprimit komunal për strehim familjar për Komunën e Lipjanit.
7. Propozim Vendim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës.
8. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve.
9. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Kosova -Women 4 Women.
10. Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.

Pastaj Kryesuesi Daut Azemi, tha se kemi propozim edhe për një pikë shtesë për rendin e ditës, të cilat i lexoi në vazhdim:

11. Propozim vendim për dhënie e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë për subvencionim të qumështit.

Pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për, aprovoi rendin e ditës, me dy pikat shtesë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 35-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimitisht me 7 vota për, Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 35-të të KPF-së

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim propozimin.

Pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimitisht me 7 vota për, aprovoi Propozimin.

Pastaj kryesuesi tha po vazhdojmë me piken e 6-te nëse pajtoheni pasi që drejtori ka një takim zyrtar.

VI

Propozim Vendim për miratimin e Planit të veprimit komunal për strehim familjar për Komunën e Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit drejtor i DSHPS , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se a ka familje të interesuar për të strehuar fëmijë, sepse është një iniciative e mirë edhe pse ishin goxha do kritere.

Shkelzen Hajdini, tha se po ka të interesuar disa familje edhe pse janë disa kritere të cilat duhet me i plotësuar.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF – ja me 7 vota për , aprovoi propozimin.

Pastaj kryesuesi i KPF-së, Daut Azemi, tha se piken e 2,3, 4 dhe 5 te rendit te ditës a pajtoheni qe te shkoj direkt për kuvend për diskutim.

Pastaj Kryesuesi vuri në votim propozimin dhe pas votimit konstatoi se KPF – ja me 7 vota për , aprovoi propozimin.

VII

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF – ja me 6 vota për , aprovoi propozimin.

VIII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF – ja me 6 vota për , aprovoi propozimin.

IX

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Kosova -Women 4 Women.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF – ja me 7 vota për , aprovoi propozimin.

X

Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, drejtor i DKA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se çka ndodh nëse ministria e vonon konfirmimin e ligjshmërisë ose e kthen negativ të këtij vendimi.

Rasim Hasani, tha nëse ndodh kjo atëherë konkursi duhet te anulohet, pasi që me këtë rregulloren e re Ministria na ka sjell telashe të mëdha.

Daut Azemi, kryesues i KPF-së, tha se a duhet për çdo konkurs të bëhet komision apo?

Rasim Hasani, tha se po për çdo konkurs duhet të jentë një komision.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF – ja me 6 vota për , aprovoi propozimin.

XI

Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë për subvencionim te qumështit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepi, drejtor i DBPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF – ja me 7 vota për , aprovoi propozimin.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 10:55

Ekstraktin e hartoi

*Zyrtari Ligjor
Behar Aliu*

*Kryesuesi i Komitetit
Daut Azemi*